


## Statistikat Tregtare te Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Maqedoninë e V.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) shkëmbimi tregtar me Maqedoninë e V.<sup>1</sup>, për vitin 2025, deficiti tregtar ka shënuar një rritje prej 40.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke arritur në -213.3 milionë euro nga -151.6 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti ka arritur në 39.4%

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Maqedoninë e V. sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	119.2	121.6	146.1	138.5
Import	282.1	294.9	297.7	351.7
Bilanci tregtar	(162.9)	(173.3)	(151.6)	(213.3)
% e mbulimit	42.3%	41.2%	49.1%	39.4%
Rritje Exp. (v-m-v) %	37.6%	2.0%	20.1%	-5.2%
Rritje Imp. (v-m-v) %	16.8%	4.6%	0.9%	18.1%
Bila. Treg. (v-m-v) %	5.2%	6.4%	-12.5%	40.6%


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

<sup>1</sup> Maqedonia e Veriut, zyrtarisht Republika e Maqedonisë së Veriut, është një vend pa dalje në det në Evropën Juglindore, me kryeqytet Shkupin. Ka një sipërfaqe prej 25,436 km<sup>2</sup> me rreth 1.81 milion banor. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rreth 19,1 miliardë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 10,546 \$ (dollar amerikan).

Analizuar në periudhën e fundit katërvjeçare, paraqitet një trend rritës i eksporteve me një mesatare vjetore prej rreth 13.6%, por përkundër trendit rritës në vitet paraprake, viti 2025 shënoi një thyerje të këtij trendi me një rënie të eksporteve prej 5.2%, gjë që kontribuoi drejtpërdrejt në thellimin e deficitit tregtar, ndërsa te importet kryesisht kanë trend në rritje në mesatare vjetore prej rreth 10.1%. Deficiti tregtar me Maqedoninë e Veriut ka regjistruar një rritje mesatare vjetore prej rreth 9.9%.

Si rezultat i këtij trendi, deficiti tregtar me Maqedoninë e V. nga viti në vit mbetet i lartë, shkalla e mbulimit të importit me eksport ka rënë 39.4 %. Rënia e shkallës së mbulimit të importit nga eksporti në 39.4% (nga 49.1% sa ishte në vitin 2024) reflekton një dobësim të pozicionit konkurrues të produkteve kosovare për këtë periudhë, njëherit tregojnë se Kosova importon me shumë se dyfishin vlerë mallrash, se sa eksporton në tregun e Maqedonisë së Veriut.

Figura 2. Eksport/Importi me Maqedoninë e V. sipas viteve në milion Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)


Maqedonia e V. nga viti në vit zë një vend të rëndësishëm në eksportin e Kosovës. Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të exportuara arrin në 138.5 milion Euro apo 14.7% si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm, renditet e dyta në listën e 10 vendeve kryesore të eksportet.

Importi i mallrave nga Maqedonia e V. arritën në 351.7 milion Euro apo 5.0% si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm, renditet e katërta në listën e 10 vendeve kryesore të importet.

## Struktura e Eksportit/Importit me Maqedoninë e V. në 2024 - 2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve

Sipas të dhënave nga Open\_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesor të **Eksportit** e përbëjnë: 35.9% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 16.4% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.4% Produktet Minerale; 5.2% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 4.9% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 4.7% Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 4.4% Produkte bimore; etj si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm me Maqedoninë e Veriut.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe Open\_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rënia e eksporteve për -5.2% apo rreth 7.6 milionë euro më pak mallra në tregun maqedonas në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia te sektorët kyç si, Produkte minerale (nga 14.8% në 11.4%), Plastika dhe goma (nga 8.3% në 5.2%) dhe një rënie e lehtë te Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 36.2% në 35.9%) etj.

Te **Importet** për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 42.6%; Produktet minerale; 21.3% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 6.9% Produkte të industrisë kimike; 5.8% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 5.6% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 4.6% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 3.3% Yndyrëra; 3.2% Produkte bimore; etj si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm nga Maqedonia e Veriut.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe Open\_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 18.1% apo rreth 54 milionë euro më shumë mallra te importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Produkte minerale (nga 33.7% në 42.6%), Yndyrëra (nga 2.0% në 3.3%) dhe një rritje e lehtë te Makineri, paisje mekanike dhe elektrike (nga 4.4% në 4.6%) etj.